

# Fuqizimi i Qëndrueshëm i pyjeve Komunale II - Shqipëri

## Promovimi i fuqizimit të grave në pyje Te drejta të barabarta dhe mundësi ekonomike

### STRATEGJIA MBI CËSHTJET GJINORE



Ky dokument paraqet përfaqshjen dhe strategjinë e projektit II të Fuqizimit të Qëndrueshëm të Pyjeve Komunalë për të garantuar përfshirjen e aspekteve gjinore në aktivitetet e projektit si dhe ndikimin mbi qëndrimet dhe sjelljet e të interesuarve që i japin tempin marrëdhëniesve gjinore.

Promovimi ynë mbi barazinë i referohet të drejtave të barabarta, përgjegjësisve dhe mundësisve të burrave e grave si dhe djemve e vajzave. Kjo nuk do të thotë që burrat dhe gratë do të bëhen të njëjtë por do të thotë që mundësitë që ju krijohen burrave dhe grave nuk varen nga fakti nëse ato janë meshkuj apo femra.

Strategjia jonë ndërtohet në mënyrë të atillë që eksperiencat e burrave dhe grave luajnë një rol integral në dizajnimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të projektit. Qëllimi përfundimtar është që të arrihet barazia gjinore, në mënyrë të tillë që burrat dhe gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe që pa barazia të mos jetë e përjetëshme.


Eksperiencia në sektorin pyjor tregon se burrat dhe gratë marrin pjesë dhe përfitojnë në mënyra të ndryshme nga aktivitetet në pyje dhe programet e zhvillimit dhe se kërkohet shumë më tepër punë për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore. Studimet tona kanë treguar se gratë nuk përfaqsohen sic duhet në proceset e vendim marrjes në institucionet lokale pyjore, që dominohen gjerësisht nga burrat. Përmbledhtazi, pengesat kryesore për pjesëmarrjen e grave në sektorin e pyjeve përfshijnë:

- Mungesë ndërgjegjësimi mbi rolet dhe të drejtat;
- Pjesëmarrje e kufizuar në zinxhirin e vlerave që lidhet me pyjet si dhe aktivitetet ekonomike;
- Pjesëmarrje e kufizuar në organet vendim marrëse të tillë si shoqatat lokale të përdoruesve të pyjeve;
- Kontroll i kufizuar mbi burimet;
- Njohje e dobët e të drejtave mbi pronësinë;

Kjo Strategji Gjinore do të drejtojë ndërhyrjet mbi çështjet gjinore përmes Fuqizimit të Projektit II të Pylltarisë së Qëndrueshme Komunale, duke trajtuar dhe pengesat e përmendura më lart. Vizioni mbi promovimin e çështjeve gjinore brenda projektit e më gjërë është:

**‘Të sigurojë që si burrat ashtu edhe gratë kanë mundësi të kontribuojnë dhe përfitojnë në mënyrë të barabartë në pyje përmes vendim marrjes dhe përdorimit’.**

Vizioni i përgjithshëm mbështetet nga një numër parimesh, që nga ana e tyre përbëjnë themelin për aktivitetet në të ardhmen. Parimet përfshijnë:





## Fuqizimi I Qëndrueshëm i Pyjeve Komunale II

është një program tre-vjeçar për forcimin e mëtejshëm të kapacitetit të shoqatave të përdoruesve lokalë të pyjeve dhe kullotave dhe njësive të qeverisjes vendore në veçanti, forcimi i lidhjeve ndërmjet aktorëve dhe grupeve të interesit për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave komunale. Ai promovon vendimmarrjen e decentralizuar dhe planifikimin e përmirësuar, në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal më përfshirës. Kjo përfshin të drejta më të sigurta mbi pronën dhe mundësi të përmirësuar për gjenerimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale, me një focus të veçantë në promovimin e barazisë gjinore.

Projekti po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Federatën Kombëtare të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale dhe është bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës përmes SNV Organizatës Hollandeze për Zhvillim.

## Metodologjia

Me qëllim trajtimin e një çështje të tillë brënda projektit do të ndiqen dy ndërhyrje, së pari të ngrihet niveli i ndërgjegjësimit mbi çështjet gjinore përmes diskutimeve me pjesëmarrje dhe analizave dhe së dyti ndërmarrja e veprimeve përmes fuqizimit të rolit të grave në pyje, duke trajtuar të drejtat e barabarta dhe mundësinë ekonomike janë si më poshtë:

**A Ndërgjegjësimi mbi çështjet gjinore** përmes diskutimeve me pjesëmarrje, analizave dhe monitorimit si nga burrat dhe nga gratë:

- Identifikimi i situatës aktuale në bordet e shoqatave të përdoruesve lokalë dhe komisioneve të fshatrave të komunave pilot – Gjendja bazë përmes analizave të aspekteve gjinore;
- Ngritja e ndërgjegjësimit mbi promovimin e respektit dhe komunikimit të ndërsjellët të të interesuarve për të mundësuar pjesëmarrje dhe përfaqsim të barabartë;
- Përcaktimi i pikave të synuara dhe momenteve kyce përmes pjesëmarrjes;
- Realizimi i takimeve për vetë reflektim me pjesëmarrje në nivele të ndryshme të organizimit (përdorues, fshat, komunë, rajon);
- Realizimi i vlerësimit të organizimit gjinor për vetë reflektim dhe planifikim të veprimeve;
- Realizimi i trajnimeve të fokusuara në aspektet gjinore me të gjithë të interesuarit në nivele të ndryshëm (fshat, komunë dhe rajon) përqëndruar në grupin e synuar;
- Përqëndrimi në të ardhurat e familjes, analizimi i kontributit të përpjekjeve nga anëtarët e familjes;

**B Fuqizimi i grave** – të drejta të barabarta dhe mundësitë ekonomike

Synohet të rritet forca reale e grave mbi vendimet ekonomike që ndikojnë në jetën e tyre. Kjo do të përqëndrohet në mundësinë e përdorimit dhe kontrollin mbi burimet kritike ekonomike. Kështu do të synohet të rritet ndërgjegjësimi, të stimulohet interesi, të stimulohet nevoja për tu shprehur, përfaqësimi për barazi, për të siguruar se ka barazi të mundësive vecanërisht mundësi ekonomike në tregje. Ky fuqizim do të trajtohet përmes veprimeve të mëposhtme:

- Krijimi i grupeve kyc/grupeve të prodhuesve në 6 rajone.
- Inkurajim i përfshirjes së grave në bordet e ShPPK dhe komisionet e fshatrave;
- Përfshirja e grupeve të grave prodhuese në veprime që cojnë në zhvillimin e zinxhirit të vlerave;
- Aktivitetet ekzistuese të përfshijnë më shumë gra për prodhim, ndarje informacioni, analiza të tregut si dhe aktivitete me të interesuar të shumtë lidhur me çështjet gjinore;
- Realizimi i analizave të bizneseve ekzistuese të grave dhe mundësitë e tyre aktuale për hyrje në tregje si për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm dhe për të krijuar modele, për të rritur mundësitë e futjes në treg, mundësitë për marrje informacioni si dhe për pjesëmarrje në panairë. (në mënyrë të barabartë).
- Identifikimi i praktikave të mira brenda rajoneve dhe eksperiencat ndër kufitare sikurse dhe shkëmbimi i eksperiencave brënda dhe jashtë rajoneve;
- Lidhje dhe shkëmbime me programet bujqësore;
- Të sigurohet se aktivitetet e grave për jetesë të tilla si grumbullimi i bimëve medicinale dhe atyre aromatike është i integruar në analizat strategjike të Qeverisjes Vendore.
- Ndërtimi i kapacitetit të grupeve kyc të grave si dhe grupeve prodhuese mbi teknikat e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve sikurse dhe aspektet gjinore dhe ato organizative.
- Ngritja e dialogut midis të interesuarve për fuqizimin ekonomik të grave;
- Rritja e përfaqësimit të grave në bordet e ShPPK me të paktën 30% në fund të projektit në të 6 Rajonet.

Projekt i bashkefinancuar nga:



Ne partneritet me:



**Connecting Natural Values & People**

Zayed Centre Floor 7, Tirana e Re

PO Box 1735

Tirana, Albania,

Tel +355 4 222 9642, +355 4 2229551

www.cnvp-eu.org